

**VENDIM**  
**Nr.218, datë 6.3.2009**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.862, DATË 20.12.2006 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TË**  
**SHPËRNDARJES” SHA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, dhe të neneve 168 e vijues, e 181 e vijues, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.862, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Në fund të pikës 5 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Nga ky rregull bëjnë përjashtim kreditë, ndërmjet KESH sh.a. dhe Bankës Europiane të Investimit, në shumën 2,3 (dy presje tre) miliardë lekë, dhe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore, në shumën 2,68 (dy presje gjashtëdhjetë e tetë) miliardë lekë, sipas specifikimeve, të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, detyrimet e të cilave nuk do t’i transferohen OSSH, sh.a.”.

2. Pas pikës 5/2 shtohen pikat 5/3, 5/4 e 5/5, me këtë përmbajtje:

“5/3. Asetet e financuara nga kreditë afatgjata, të përfunduara gjatë vitit 2008, nga KESH sh.a. për OSSH sh.a. në shumën 1,1 (një presje një) miliardë lekë, t’i transferohen Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. dhe të regjistrohen në pronësi të këtij operatori.

Autorizohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ta pasqyrojë këtë transferim në formën e uljes së kapitalit të KESH sh.a. dhe të rritjes së kapitalit të OSSH sh.a. përkatësisht në vlerën e përcaktuar më lart.

5/4. Detyrimet afatshkurtra, për blerjen e energjisë elektrike dhe tarifën e transferimit, që OSSH sha, ka, respektivisht, ndaj KESH, sha, dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. deri në shumën 1 (një) miliard lekë, të shuhen dhe të pasqyrohen si rritje kapitali e OSSH, sh.a.

Autorizohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të kryejë veprimet e nevojshme, për pasqyrimin e këtij veprimi.

5/5. Shuma prej 0,53 (zero presje pesëdhjetë e tre) miliard lekë, që i korrespondon pagimit të huave afatgjata, në vitin 2008, nga KESH sh.a. të pasqyrohet si rritje kapitali për OSSH sh.a.

Autorizohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të kryejë veprimet e nevojshme për pasqyrimin e këtij veprimi.”.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**